




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 29.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **25.09.2020**, të parashtruar nga **Operatori Ekonomik "Bejta Commerce sh.a"** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova " me nr të prokurimit 651-20-2807-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 026 521** nxjerr:

### V E N D I M

**Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë **Operatori Ekonomik "Bejta Commerce sh.a"** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova " me nr të prokurimit 651-20-2807-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 026 521** e dt. **25.09.2020** kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 23.09.2020 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

- 1. AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 23.09.2020**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

### A r s y e t i m

**Operatori Ekonomik "Bejta Commerce sh.a"** me datës **25.09.2020** ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova "** me nr të prokurimit **651-20-2807-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 026 521** Autoriteti Kontraktues me datë **29.09.2020** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Pretendimi Ankimor 1:** Dyshojme se Operatori i shpallur fitues nuk i plotson kërkesat e FTD ndaj edhe pas kërkeses se disahershme nga ana jone qe ti shohim dokumentet e operatorit te shpallur fitues nuk po na lejohet qasja ne keto dokumente me pretendimin se i ka te cekura si sekrete afarist.

**Përgjigje 1:** Menjehere pas njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues te **dt.23.09.2020**, kemi pranuar emailin nga **"Bejta Commerce sh.a"** ku keni kerkuar qasje ne dokumentacionin e OE i cili eshte shpallur fitues per kete aktivitet.

**AK** ka konstatuar qe **Grupi i Operatorëve Ekonomik: K.N.T.SH. " Teuta - M " Sh.p.k.; N.T. "Rahovica Comerce"**, ka te plotesuar **Aneksin 3 kerkesa per sekrete afariste – kapacitetet ekonomike financiar si dhe kapacitetin teknik dhe profesional, me arsyetimin se te dhenat prej ketij tenderi –projekti mund ti perdorin per tender-projekte tjera.**

**AK** permes emailit me **dt 24.09.2020** ka kerkuar nga **GR.OE K.N.T.SH. " Teuta - M " Sh.p.k.; N.T. "Rahovica Comerce"** qe te ju lejohet qasja e plote OE te cilet jane te interesuar. Me dt. 25.09.2020 **"TEUTA-M" SH.P.K** eshte pergjigjur permes emailit si me poshte:

*Krejt ne fund sa i perket kerkeses suaj per lejimin ne qasje ne dokumentacion, ne me vetedije e kemi mbushur formularin e aneksit nr.3 sipas ligjeve te krpp-se per sekret afarist dhe cdo ndryshim i dokumentacionit i tenderit pasi te dorzohet ai permбан shkëlqje, dhe per kete nuk mund ta lejojme. Gjithashtu mbi gjithhecka ne besojme ne objektivitetin dhe vleresimin tuaj si prokurim ne momentin kur keni vendosur qe neve si OE te na shpallni fitues ne tenderin ne fjale.*

**Autoriteti Kontraktues duke u bazuar ne Ligjin e LPP-se Neni 11 paragrafi 3,3.1,3.2,3.3 (Informatat Sekrete Afariste), ka rrespektuar kerkesen e Grupit i Operatorëve Ekonomik: K.N.T.SH. " Teuta - M " Sh.p.k.; N.T.**

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar të gjitha pikat ankimore të Operatorit Ekonomik "Bejta Commerce sh.a" ku të gjitha pretendimet ankimore bien poshtë dhe mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës.

Izet Kurteshi  
ZPZP

